



EUROPEAN CENTRE  
FOR MINORITY  
ISSUES KOSOVO



# PRESS RELEASE

Kumtesë për Media  
31 DHEJTOR 2020

## PAJISJE TË REJA PËR QENDRAT SHËNDETËSORE NË PJESËN VERI-PERËNDIMORE TË KOSOVËS.

Sot, pajisje të reja për mbrojtjen e shëndetit riprodhues u prezantuan dhe u dorëzuan zyrtarisht në rajonin e Duakgjinit, të cilat u blenë për qendrat shëndetësore të Spitalit Rajonal të Pejës dhe Gjakovës si dhe për qendrat kryesore të mjekësisë familjare në Pejë, Klinë, Istog dhe Deçan në kuadër të projektit CARES, i cili po zbatohet në Kosovë nga ECMI Kosova. Vlera totale e pajisjeve të blera është 45,676.90 EUR, e cila përbëhet nga dy pajisje ultratinguj, kolposkopë, CTG, sterilizues dhe grupe instrumentesh dhe kimikate për provat PAPA. Projekti CARES – Aktivitetet ndërkuftare në sektorin e shëndetit riprodhues financohet nga Bashkimi Evropian përmes Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë\*. Autoriteti kontraktues për projektin është Ministria e Financave e Malit të Zi - Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Fondeve të Mbështetjes së BE-së.

Projekti në Kosovë zbatohet nga ECMI Kosova – Qendra Evropiane për Çështje të minoriteteve në Kosovë, në komunat Pejë, Gjakovë, Klinë, Istog dhe Deçan. Qëllimi i projektit është të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në sektorin e shëndetit riprodhues dhe të informojë qytetarët për rëndësinë e parandalimit dhe ruajtjes së shëndetit riprodhues. Projekti ka filluar më 1 Mars 2019 dhe zgjat deri më 31 Dhjetor 2020.

Përveç blerjes së pajisjeve të reja, aktivitete të tjera të shumta janë zbatuar deri më tani, duke përfshirë ligjerata mbi parandalimin e kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës, shpërndarjen e një broshure mbi këtë temë dhe shpërndarjen e materialit promovues që përmban një mesazh në lidhje me rëndësinë e parandalimit, transmetimi i videos , fushata mediatike dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Një aktivitet shumë i rëndësishëm i projektit është gjithashtu fushata e organizimit të ekzaminimeve parandaluese, e cila kryhet në bashkëpunim me qendrat shëndetësore dhe spitalet në komunat e synuara.

Ne e përdorim këtë mundësi për t'i kujtuar grave dhe vajzave të reja që të kryejnë rregullisht ekzaminime parandaluese dhe kështu të kontribuojnë në ruajtjen e shëndetit. Kontrollat e rregullta mund të lehtësojnë shumë trajtimin e sëmundjeve të caktuara malinje, dhe në disa raste madje parandalojnë plotësisht shfaqjen e tyre.

Për më shumë informacione mund të kontaktoni znj. Blerta Visoka nga ECMI Kosova – Zyrtare e Programit në tel: +383 (0) 38 224 473.

\*Ky mbishkrim nuk paragjykon statusin e Kosovës dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe opinionin i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE - KOS  
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDERKUFITAR  
MALI I ZI - KOSOVE 2014-2020